

## N-192 Zëvendësimi i Linjës së Transmetimit të Beverly Salem

### Plani i kontrollit të zhurmës

McCourt Construction ka hartuar një program për të kufizuar ndotjen akustike të tepërt dhe problematike që lidhet me aktivitetin e projektit si pjesë e zëvendësimit të linjës së transmetimit të Beverly Salem për National Grid. McCourt ka për qëllim të veprojë sipas këtyre udhëzimeve gjatë zhvillimit të këtij projekti, si dhe të trajtojë shqetësimet specifike që mund të lindin gjatë ndërtimit.

- Orari normal i punës nis në orën 7:00 të mëngjesit deri në 15:30 pasdite, nga e hëna në të premte. Puna gjatë periudhave të tjera kohore, e cila mund të konsiderohet jashtë orarit normal të punës, do të koordinohet me kujdes në bashkëpunim me stafin drejtues të projektit për të minimizuar efektet që mund tu shkaktohen pronarëve fqinjë.
- McCourt do të planifikojë përdorimin e pajisjeve më të vogla aq sa është e mundur që të kryhet puna e projektit për të ndihmuar në minimizimin e efekteve të zërit.
- Të gjitha pajisjet e ndërtimit, duke përfshirë automjetet e dorëzimit dhe kantierit, duhet të përdorin sistemet e duhura zhurmëmbytëse të shkarkimit të motorit. Ndalohet rreptësisht përdorimi i frenimit të kompresionit të motorit, ose "Jake Brakes" për automjetet e projektit.
- Në përputhje me ligjin e shtetit të Massachusetts, nuk do të lejohet lënia ndezur e motorit për periudha të gjata kohore për automjetet që nuk janë në përdorim.
- Do të merret parasysh vendosja e çdo pajisjeje të palëvizshme, si gjeneratorët ose pompat, në distancën maksimale të volitshme nga banesat ose receptorët e tjerë potencialisht të ndjeshëm.
- Nuk do të lejohet përdorimi i radiove për qëllime argëtimi në zonat e banuara. Gjithashtu, do të kufizohen gjatë gjithë kohës bisedat dhe komunikimi i panevojshëm ose me zë të lartë, në mënyrë që të mos shqetësohen pronarët fqinjë.
- Duhet të përdoren mbulesa për izolimin e zhurmës në gardhin rrethues të zonave të punimeve. Përdorimi i mbulesave do të aplikohet në vendndodhjet e pusetave dhe jo përgjatë gjithë itinerarit të projektit. Përdorimi i pajisjeve më të vogla do të vihet në zbatim përpara përdorimit të mbulesave për izolimin e zhurmave për shkak të zonës së kufizuar të ndërtimit që McCourt po përpiket të respektojë gjatë projektit.
- McCourt do të punojë me mirëbesim për të zbutur punimet që prodhojnë zhurmë të tepërt në zona veçanërisht të ndjeshme dhe do të përgjigjet duke vendosur masa të arsyeshme rreth ankesave që mund të lindin nga pronarët fqinjë.